



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 71 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25/ 05 / 2023

VENDIM

Nr. 16, date 25 /05/2023

PËR

INFORMACIONIN NE LIDHJE ME NUMRIN E NJEREZVE NE RREZIK NE ZONAT URBANE POSHTE DIGAVE TE MEDHA NE RASTET E PRURJEVE TE MEDHA DHE PRISHJES SE MUNDSHME TE NDONJE DIGE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave" si dhe Udhezimit Nr. 248, date 28.01.2001 "Per hartimin e planit të alarmit, evakuimit dhe ndihmes për mbrojtjen e popullates dhe të vlerave materiale në rastet e jashtzakonshme si pasoje e prishjes së digave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.05.2023 mori në shqyrtim problematiken e mungesës së ketyre planeve, mungesën e hartave të përmbytjeve në rastet e prurjeve të mëdha dhe prishjes së mundshme të digave të mëdha si dhe të mungesës së informacionit nga shfrytëzuesit e Digave të Ujitjes.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM,

VENDOSI:

- Të kërkoj të gjitha bashkive që shfrytëzojnë digat e mëdha për ujitje një informacion të detajuar në lidhje me numrin e njerezve në rrezik në rast të prishjeve të mundshme të diges apo prurjeve të mëdha që ndodhen në zonat e banuara poshte ketyre digave. Ky informacion duhet të dorëzohet pranë KKDM/ SKDM brenda muajit Korrik 2023.
- Tu kërkoj Bashkive që shfrytëzojnë digat e mëdha për ujitjes, hartimin e planit të alarmit dhe të hartave të përmbytjeve sipas nenit 35 të VKM se mësipërme Nr. 147, date 18.03.2004 dhe Udhezimit Nr. 248, date 28.01.2001. Këto plane dhe harta të përmbytjeve duhet të dorëzohen pranë KKDM / SKDM brenda muajit Nendor 2023

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

